



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. Br. Prot.
 Nr. i faq. 03-03/DPK Data 01-2354/16
 Broj stranica 02 Date 19-07-2016
 Nr. pages 02 PRISTINE

DATE/A:	15.07.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP 03-03/1728/15
PËR/ZA/TO:	z. Burim ZEKAJ, Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Ndërmarrjen Publike Trainkos sh.a.
CC:	z. Gelor SHALA , Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Trainkos sh.a.
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizimi me vajra dhe lubrifikante "

I nderuari z. Zekaj ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Furnizimi me vajra dhe lubrifikante " me numër prokurimi TRA-16-31-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Në lidhje me monitorimin e procesit rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve lidhur me aktivitetin e prokurimit publik me titull "Furnizimi me vajra dhe lubrifikante" me numër prokurimi TRA-16-31-121, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ndërmarrja Publike Trainkos sh.a.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 12.05.2015, ka nxjerrë vendim me numër protokolli *AKK-03-03/1728/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull *"Furnizimi me vajra dhe lubrifikante"* me numër prokurimi *TRA-16-31-121*, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ndërmarrja Publike Trainkos sh.a.

Me datë 13.05.2016, Agjencia ka paraqitur kërkesën për dokumentacion me të cilën ka kërkuar dokumentacionin përkatës para hapjes së tenderit. Autoriteti kontraktues i ka vënë në dispozicion dokumentet e kërkuara AKK-së. Agjencia pasi ka trajtuar dokumentet e këtij aktiviteti të prokurimit ka vendosur që të merr pjesë në procesin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave në cilësinë e vëzhguesit.

Agjencia me datë 06.06.2016 ka paraqitur njoftimin për pjesëmarrje në vëzhgim pranë Autoritetit kontraktues të cilin e ka njoftuar se do të merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në procesin rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve. Agjencia pasi ka trajtuar dokumentet në dispozicion dhe ka marr pjesë në monitorimin rreth vlerësimit të tenderëve ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë Procedurën e hapur, kontratë të llojit furnizim me vlerë të madhe të kontratës.

Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 16 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar 3 prej tyre.

Komisioni vlerësues, pasi ka bërë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e ofertave ka konstatuar se në këtë aktivitet të prokurimit kanë tenderuar 3 Operator ekonomik ku vetëm njëri prej tyre ka dorëzuar tender të përgjegjshëm në pajtim me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit si dhe ka ofruar çmimin më të ulët, andaj Komisioni ka rekomanduar që OE i përgjegjshëm të shpallet fitues.

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se pas ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit vlerësues dhe monitorimit të bërë nga Zyrtari përgjegjës i AKK-së nuk ka prova me të cilat do të evidentohet ndonjë shkelje e dispozitave të LPP-së, andaj kërkon nga Autoriteti kontraktues që të procedojë me këtë aktivitet të prokurimit konform Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik .

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !